



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL XI/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 11 (njëmbëdhjetë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.11.2024
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z. Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Doruntina Zenelaj
Z. Alban Berisha
z. Xhevshet Gashi
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj. Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj. Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Edon Sadikaj
Znj. Saranda Bajraktari
Znj. Mimoza Bajraktari
Znj. Festë Kabashi
Z. Dardan Berisha
Z. Bajram Basha
Znj. Mevlude Kabashi
Znj. Sheqerije Zyrapi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Liridon Fandaj
Z. Qëndrim Elshani
Z. Herolind Limaj
Znj. Jehona Lumi-
Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe zëvendës drejtor të IEAA-AP;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesave;**
- 6. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - pasi nuk ka vërejtje,e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - në KPF kam kërku nga Drejtori i Pronës që të na sjell një vendim në lidhje me këtë pronë dhe ndarjen që është bërë në vitin 2022 pasi që ajo ndarje ka qenë pa vendim të Asamblesë por Drejtori i Pronës ka thënë që ne e kemi një vendim të 2013-tës dhe në ftesën për Adsamble nuk e ka bashkangjit. Sa e di, Drejtori atë ditë ka thënë që kjo lëndë është duke u hetu. Unë jo zyrtarisht kam marrë informatë që kjo lëndë ka kallzim penal. A ka vendim në 2013-tën dhe a mund të na faktoj këtë vendim?

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit. Ndarja në të cilin po flisni ju, nuk ka të bëjë sepse po flisni për një proces tjetër. Ndarja për të cilën flisni është nda në bazë të një vendimi të Asamblesë komunale dhe po ashtu e kemi të paraparë në hartën zonale ku me eksoficio, ne patjetër të gjitha ato që i ka parapa HZK, ne duhet të marrim vendime për ti hapur rrugët publike.

Liridon Fandaj - unë desha ta shoh vendimin dhe nëse mund të referohesh cili është vendimi për ndarjen e parcelës. Unë e kuptoj që ky vendim nuk është për atë pjesë por nëse ajo parcelë është nda pa vendim të Asamblesë edhe ky proces është i pamundur m'u zhvillu.

Armend Krasniqi - disa vendime të cilat i sjellin për me kriju rrugë, më nuk kemi nevojë me sjell në Asamble por këtë nuk po mund ta sqarojnë mirë zyrtarët ligjor dhe juristat ne Drejtorinë time, andaj unë jam bazu në HZK edhe për kundër një vendimin tjetër të cilin e kemi pas, për me ndarë një parcelë të Hendikosit në Suharekë.

Liridon Fandaj - nëse ti ma siguron vendimin për ndarjen e parcelës, jemi në rregull por nuk mund të thuash me HZK sepse të gjitha pronat publike për çdo ndarje duhet me kalu përmes Asdamblesë.

Armend Krasniqi - e kemi edhe vendimin dhe ashtu siq e ceke lënda është duke u hetuar. Kemi qenë dhe kemi konstatuar se është gjithëçka në rregull dhe shumë shpejt pritete me u mbyll.

Kryesuesi - definoje që jo për këtë rast.

Armend Krasniqi - parcela prej 348 m² nuk ka lidhje me këtë që po flisni ju.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit. Kërkoj sqarime më detale prej drejtorit se ku është qëllimi i këtij projekt-vendimi që do ta japim pëlqimin?

Armend Krasniqi - Komuna në rastin konkret e përfiton një vlerë mbi 300.000 €. 348 m² e shëndrron në banesa.

Flamur Bytyçi - nëse mundet me na sqaru zyrtari ligjor çështjen që e diskutoi Liridoni. A duhet me pas vendim për çdo parcelë që ndahet apo jo?

Urim Suka - ne mendojmë që barra kryesore e kësaj që po zhvillohet bie mbi sponsorizuesin e atij që e ka sjell këtë vendim dhe në këtë rast drejtorit apo edhe juve si pushtet. Ne si asambleista jemi duke dasht me marrë një vendim i cili i bie mirë edhe qytetarëve dhe komunës që ajo parcelë mu kthy dhe me përfitu edhe komuna. Por para se me marrë këtë vendim asnjëherë ne nuk duhet me ra në lajthitje dhe me marrë vendime që kanë probleme ligjore. Ky vendim që ne po e marrim, a është i përgaditur mirë ligjërisht dhe nëse ne e votojmë nuk bëjmë ndonjë shkelje? Nëse është në rregull, jemi për me mbrojt interesin qytetar dhe me u zhvillu edhe komuna.

Armend Krasniqi - vendimet që i sjellim, sidomos drejtoria ime, i sjell në mënyrën më profesionale të cilat kurrë nuk kontestohen as nuk kundërshtohen nga MAPL-ja. Kjo është më shumë se sa në rregull andaj mos keni asnjë dyshim.

Urim Suka - e vërteta është që shumë herë po ndodh që vendimet kthehen, sidomos drejtorisë tënde. Ku mbet procedura e ndërrimit të emrave të shkollave drejtor? Sepse me entuziazëm e patët sjell atëherë ti dhe Drejtori i Arsimit. Keni thënë që keni me rregullu dhe e keni harru dhe është vetëm një prej vendimeve që të është kthy.

Laureta Tafaj - i nderuar z. Krasniqi si më i miri i më të mirëve. Nuk je i shenjtë për me t'besu me sy mbyll qysh po e bën. A mund të na sjellësh vendimin e pastaj e vendosim a me votu, a mos me votu.

Armend Krasniqi - parcelën të cilën e kemi inicuar për me dhënë në shfrytëzim për 99 vite, nuk ka lidhje me vendimin që po kërkon ti.

Laureta Tafaj - vetëm sille vendimin.

Armend Krasniqi - specifikoj vendimin që po e kërkon dhe do ta sjellim.

Liridon Fandaj - nëse unë e kam kërku një vendim dhe ky nuk e ka bashkangjit, ky është i obliguar me sjell vendimin mbi ndarjen e asaj parcele. Nuk po e kontestoj vendimin që e ka kompletu tash por po ia kontestoj ndarjen që thotë në 2013-tën.

Armend Krasniqi - këtu e kemi sjell një prcellë 348 m² dhe nuk ka të bëj me asnjë vendim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

17 për, 4 kundër, 5 apstenime, Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit. Më vje mirë që erdh një pikë e ngjashme me pikën që e kemi diskutu mbledhjen e kaluar dhe bashkë me drejtorin e kemi pas një diskutim ku konkretisht diskutimi im në pikën e kaluar ka qenë që lënda ka qenë totalisht e pakompletuar dhe nuk kemi pas mundësi me diskutu rreth përmbajtjes së asaj pike për shkak se nuk kemi pas dokumentacion. Mua më vje mirë që tash keni pas mundësi sa do pak me analizu këtë kërkesë. Ne e kemi diskutu edhe në KPF dhe unë e kam një pyetje për Drejtorin e Pronës dhe Drejtorin e Urbanizmit që nuk qenka prezent sot. A po krijohet zgjidhja? A po pastrohet blloku ndërtimor dhe me iu liru investitorit për ndërtim me anë të këtij projekt-vendimi apo prap ka me pas barriera në momentin që adreson kërkesën për leje ndërtimore në Komunë?

Armend Krasniqi - është e vërtetë që në Asamblenë e kaluar kemi pas disa polemika të cilat MAPL i ka rrëzu të gjitha ato polemika dhe e ka konstatuar që unë e kam përgadit lëndë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe e ka kaluar si MAPL. Sa i përket se a krijohet zgjidhje e këtij blloku, është e vërtetë që me siguri nuk mundemi me pastru si bllok sepse ka disa parcela që janë ngjit më lartë në këtë sipërfaqe mirëpo sa i përket drejtorisë tone kjo është e përgaditur në mënyrën më të mirë të mundshme dhe faktikisht këmbimin të cilin kërkojmë me bo si komunë, 55 m² ia japim ku e krijojmë një alternativë për pastrimin e bllokut ndërsa 55 m² ia marrim pronarëve investitor aty ndërsa për detaje se si duhet të zgjidhet blloku dhe çfarë kategorie apo mundësie duhet të jepet leja për të vazhduar më tutje, me ato merret Drejtoria e Urbanizmit dhe besoj krijojnë një alternativë tjetër mirëpo duke u konsultuar me ta ne e kemi gjet një formë që në këtë formë me sjell këtë pikë. Ka një problem tjetër që këtu nuk e di se si duhet të shkohet por sipas Drejtorisë së Urbanizmit shkohet me bonus ndërtim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ne kemi pas diskutim konkretisht për parcelën 2760-0 në KPF ku sipas juave ajo parcelë është pasuri shoqërore -rrugë që nuk është në menaxhim të komunës dhe po e prek këtë bllok ndërtimor. Si ka m'u zgjidh ajo problematikë ?sepse ajo i takon totalisht drejtorisë.

Armend Krasniqi - lëndën e kemi të kompletuar të cilën e kemi sjell në Asamble dhe kjo është alternativa që duhet me zgjidh prona por nëse pjesa e cila mbetet e pa shpronësuar nga ana e investitorit, ne kemi detyrë eksoficio me shpronësu atë. Sa i përket pjesës së mbetur dhe zgjidhjes së bllokut ndërtimor, ne si drejtori merremi me punë të cilat i kemi në të ardhmen dhe patjetër që e gjejmë zgjidhjen sepse duhet me kriju rrugën. Ne nuk merremi a jepet leja apo nuk jepet, me këtë merret urbanizmi dhe ne po intersohemi me kriju një rrugë që e kemi parapa me HZK, ku në pjesën e parë kemi hy me këmbim dhe për pjesën e dytë se si vazhdohet më tutje, ne duhet të veprojmë sipas ligjeve në fuqi.

Sanie Kuçi Rexhepaj - e kuptoj qartë që po të interson puna jote dhe jo përtej zyrës tënde. Mua më interson të dijë se si ka me iu zgjidh problemi i investitorit. Kërkesa juaj ka ardhë duke u bazuar në kërkesën e investitorit. Cilat janë hapat që keni me zgjidh këtë problematikë apo vetëm jemi duke e bërë një hap të heshtur që ka me u mbyll si çështje dhe prap se prap investitori nuk ka me pas mundësi me ndërtu në atë bllok?

Armend Krasniqi - duke e diskutuar me ekspertat e njerëzve të cilët duan të ndërtojnë, po ashtu ekspertat e pronës dhe ekspertat e katastroit, ne e kemi konstatuar që si pikë fillestare duhet të përgatitet kjo për me shku 55 me 55. Në hapat e mëtejshme ne e kemi parapa me HZK me kriju një rrugë dhe në atë rrugë po mbetet që ne duhet me marrë masa eksoficio për me hap atë rrugë të cilën e kemi parapa me HZK. Komuna ose e paguan me bonus ndërtim ose me para sepse e ka obligative.

Sanie Kuçi Rexhepaj - për me apliku bonus ndërtimin ai duhet me pas të drejtë për me marrë leje ndërtimore. Unë po them, si keni me ardhë deri në atë pikë që ai me apliku për leje të ndërtimit?

Kryesuesi - ju pyetët se a zgjidhet problem i ndërtimit të bllokut por është çështje e urbanizmit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ju kisha lut drejtorit që nëse ka me pas kërkesa të ngjashme herave të tjera, skica e terenit dhe vijat e HZK-së me na ardhë të punuara nga gjeodetët e Komunës dhe jo nga gjeodetët privat për shkak se ne i kemi diskutu edhe në KPF gabimet teknike që janë e që dy parcela kanë numrin e njejtë kadastral.

Armend Krasniqi - është e vërtetë atë që e the mirëpo një lëndë me u kry duhet së paku 2 javë. Ne në Drejtorinë e Pronës bëjmë luftë ditore duke punu në shërbim të qytetarëve. Në këtë rast konkret, i ka marrë kordinatat në katastro operatori ekonomik duke dashur të na ndihmojë si komunë dhe ka dal i ka bërë matjet në teren, e ka sjell lëndën e përgaditur duke u konsultu me gjeodetët në Drejtorinë e Pronës dhe kemi konstatu që është gjithëçka në rregull dhe me konstatimin e kësaj rregullore ne e kemi sjell në Kuvend.

Liridon Fandaj - nëse ne me këtë material kemi me votu, e votojmë ashtu si është. Nëse e votojmë kështu, i kemi dy parcela me të njejtin numër. Prej KPF-së deri në Asamble është dasht të korigjohet që ne sot me votu me ndryshim.

Armend Krasniqi - është gabim teknik të cilin e kemi përmirësuar por faleminderit sepse është interesi i të gjithëve mos me dërgu me gabime më tutje.

Urim Suka - Drejtori thotë që puna e tij po vlerësohet nga organizatat kombëtare e ndërkombëtare. Unë në seancën e kaluar e kam bërë një pyetje edhe drejtoria e tij nuk ka aparat për ti bërë matjet kadastrale që

duhet në teren dhe një kërkesë të banorëve të fshatit Bllacë për varreza, për shkak të asaj nuk po arrin me përmbys. Ky drejtorinë ku vet e menaxhon e ka lënë pa atë aparat që është bazë e punës së tij për çështje elementare e këndeje po merr vlerësime ose po bën vetvlerësime për punën e vet.

Armend Krasniqi - aparati është një pjesë e vogël, një GPS që mund të bie në ujë dhe të prishet për një ditë mirëpo me prishjen e aparatit ne e kemi inicuar një procedurë për me ble por lënda ka shku në OSHP. Edhe pse s'ka komuna aparat, ne bashkëpunojmë me gjeodetë të cilët i kam përmendur javën e kaluar. Lëndën që e kemi pas për ndarjen e varrezave 5 hektarësh në Bllacë, aty kemi pas matje mirëpo Bllaca i kanë humb dhe ne do të shkojmë edhe një herë dhe do ta bëjmë matjen.

Urim Suka - në fund e plotësoj pjesën që tha jemi gati me i vendos pikat mirëpo drejtorinë e ka pa aparat.

Alban Berisha - përshëndet të pranishmit. Normal si opozitë shumicën e herave e votojmë kundër sepse ashtu e logjikojmë ne që duhet por pas fjalëve të drejtorit, sinqerisht do ta votoj po sepse më pasionoi sidomos me këto mirënjohjet që i ka marrë me punën e tij dhe kjo tregon që pushteti komunal është në gjumë dhe shqyrr që e kemi këtë drejtor dhe pak po iu zbardh fytyrën.

Armend Krasniqi - faleminderit për vlerësimet të cilat i bën dhe je shumë real dhe nuk të duhen për konsum ditor apo për politika ditore.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

23 për, 3 kundër, 1 apstenim, Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe zëvendës drejtor të IEAA-AP;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. E kemi diskutuar edhe në KPF por edhe herave tjera e kemi kërku një raport ku shkruan që Arta Hoti është përfaqësues i këshillit të prindërve. E kuptoj vendimin por me qenë më konkret që ta dime që Arta Hoti, a është përcaktuar prej këshillit të prindërve apo është e deleguar prej DKA-së?

Remzi Bajselmani - përshëndet të pranishmit. Arta Hoti është profesore dhe e cila ka qenë në komision edhe në të kaluarën. Ndryshimi po ndodh në komision për shkak se ish zyrtari i DKA-së Agim Rraqi është pensionuar dhe ky komision është atëherë vetëm për një konkurs dhe çdo konkurs të drejtorëve duhet të përzgjidhet një komision që në parim është detyrë e Kryetarit të komunës por DKA i propozon emrat e mundshëm dhe kredibil për këtë çështje.

Dardan Berisha - unë e bëra një pyetje konkrete dhe duresh me ditë sepse sa herë po të bëjmë pyetje po thua nuk e di dhe as përgjigje nuk po jep. Arta Hoti nuk e zëvendëson Agim Rraqin sepse është përfaqësues i këshillit të prindërve. Artën nuk e njoh dhe nuk kam asgjë kundër por vetëm kërkoj ta di, a e ke përcaktuar ti apo prindërit?

Remzi Bajselmani - nuk është detyrë e këshillit të prindërve për me përcaktuar një anëtar, është detyrë e Drejtorit të Arsimit me ia propozuar Kryetarit të komunës dhe Kryetari sipas rregullores e sjell në Asamble.

Dardan Berisha - e di procedurën ligjore që ti mund ti delegosh të gjitha por mos u thirr që është anëtar i këshillit të prindërve dhe e kanë sjell këshilli i prindërve sepse është mashtrim i opinionit. E kuptoj ligjin dhe është në rregull por vetëm të informohet opinioni si është saktë sepse unë s'kam kundër asgjë as ndaj Drejtorit, as ndaj Kryetarit dhe askujt.

Liridon Fandaj - edhe unë sikurse Dardani kërkoj sqarime. Nëse është propozim i drejtorit, duhet me thënë është propozim i DKA-së por nuk mund të jetë edhe përfaqësues i prindërve edhe me qenë në arsim duke punuar. Ne vërtetë kemi kërku një procesverbal për zgjedhjen e një përfaqësuesi të këshillit të prindërve por asnjëherë nuk e ka sjell. Edhe drejtori nuk e din a është zgjedh si përfaqësues i prindërve apo vetëm po na vje si emër dhe duhet me vazhdu.

Urim Suka - fjala e drejtorit lë me kuptuar që ky është plotësim-ndryshim e në fakt ky është projekt-vendim. Ne po e marrim një vendim sot për konkursin që është i hapur dhe ky komision me bo përzgjedhjen dhe kur të shpallet konkursi tjetër, duhet me bo komisionin tjetër. Kur të shkruan përfaqësues i këshillit të prindërve, këshilli i prindërve ekziston. Rastin e Arta Hotit ti mund ta propozosh dhe mos ta shkruash si përfaqësues e këshillit të prindërve por me propozuar si eksperte e arsimit dhe në rregull

jemi,vazhdojmë me Arta Hotin sepse unë e njoh dhe besoj mund ta përmbush këtë detyrë sepse ka pas përvoja edhe më herët.Në të gjitha vendimet tjera është mirë ti merrni më seriozisht sepse pastaj po vonohemi për një çështje që është krejt teknike,obligim i vogël që ne e kemi me përmbush.

Aziz Bytyqi - kjo është një çështje formale dhe formalisht ne duhet ta mbështesim këtë vendim.E kuptoj mirë dhe më vje mirë që askush nuk e konteston personalitetin e personit në fjalë sepse edhe unë e njoh.Profesoresha Arta Hoti është një profesoreshë e shkëlqyeshme dhe nuk ka të bëjë me asnjë çështje politike.Besoj se edhe drejtoria është nis prej parimit sepse Arta Hoti jeton në Suharekë dhe është më lehtë me marrë pjesë në këto komisione.Ajo mund të jetë edhe përfaqësuese e prindërve sepse mund ta ketë ndonjë fëmijë në atë shkollë.Unë me kënaqësi e mbështes kandidaturën e saj.

Kryesuesi - të gjithë parafolësit nuk kanë asnjë kontest te emri i saj.

Elmaze Bytyqi - te udhëzimi administrativ 01/2023 zgjedhja,themelimi dhe funksionimi i këshillit të prindërve,udhëzimi administrative në nivel qendror dhe komunal po thotë që nuk mund të jetë mësimdhënës apo udhëheqës.Unë e di që Arta Hoti është mësimdhënëse.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që ekskluzivisht sipas rregullores për përcaktimin e përzgjedhjes së drejtorëve,zëdhënës drejtorve dhe mësimdhënësve është kompetencë e DKA-së ti përcakton dy anëtarë nga Kuvendi i komunës ku një vjen nga DKA-ja dhe një vje nga ekspert të fushave të caktuara,konkretisht të arsimit.Në këtë rast drejtori ka vlerësu që zonja e cekur në projekt-vendim i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret që jetë në komision sa i përket dhe përfaqësimit të këshillit të prindërve për arsye se edhe është eksperte dhe ka ekspertizë në fushën e arsimit.Komisioni nuk është duke e bërë plotësim-ndryshimin por komisioni është duke u themelur risht për përzgjedhjen e drejtorve dhe zëvendës drejtorëve sipas konkurseve që i ka shpall DKA dhe komisioni është atëherë,ka mandat deri në përfundimin e gjithë procedurës së këtij konkursi.Sa i përket çështjes ligjore,çdo gjë është në rregull.

Alban Berisha - është e vërtetë që është kompetencë e drejtorit dhe ka të drejtë.A e ka statusin e anëtares së këshillit të prindërve një mësimdhënës?Respekt për profesoreshën dhe është e vërtetë që mund të jap kontribut të madh për përvojën që e ka.

Dardan Berisha - tjetër herë nuk ia bëj drejtorit pyetjen por zyrtarit ligjor.Unë shumë konkret isha prej fillimit.Unë nuk e njoh Artën dhe nëse dikush e njeh,mos e banalizoni sepse unë nuk kam asgjë konkret.Pasi qenka eksperte unë e propozoj për drejtoreshë të Arsimit sepse Drejtorisë së Arsimit i duhet një ekspert.

Urim Suka - nëse e bën prej këshillit të prindërve është morale,etike,me vet këshillin e prindërve.Në këtë rast nuk e ka vet këshillin e prindërve dhe e ka marrë si eksperte.Pse po ia shkruan përfaqësuese e këshillit të prindërve?Nëse ju pajtoheni dhe ndoshta edhe drejtori pajtohet që mos me shkru Arta Hoti përfaqësuese e këshillit të prindërve por me shkru si eksperte e arsimit ose e fushës dhe mund të kaloj si projekt-vendim.

Avni Bytyqi - në aspektin ligjor është në rregull por vetëm le ta jep mendimin drejtori sepse është propozim i drejtorit. Nëse drejtori vlerëson që me mbet Arta Hoti ekspert e jashtëm, nuk është problem sepse rregullorja e specifikon shumë qartë.

Remzi Bajselmani - personi për të cilin po diskutojmë i ka plotësu të tri kriteret që kërkohen sipas udhëzimit,edhe si prind që është i këshillit të prindërve,i ka nxënësit në shkollë dhe është me gradën master ekspert i arsimit dhe përfaqëson institucionin ashtu siç e kemi mendu ne dhe e kemi sjell si emër.E paanshme politike.Drejtori tutje jep sqarime.

Alban Berisha - të lus personalisht ty dhe kolegëve të tu drejtora.Kur e kemi ne një kontest juridik diçka sikurse ti që po thua keni të drejtën me votu pro ose kundra,edhe ne e kemi të drejtën me kërk se a është ligjore,a është konform normativave.Ju lus që mos e qoni asnjëherë në kontest të personalitetit të personit sepse asnjëherë këtu prej kolegëve nuk e ndëgjova që u kontestu emri i zonjës në fjalë.Nëse është profesioniste sipas jush që edhe ne po mendojmë që është profesioniste,unë personalisht do ta votoj këtë vendim por vetëm pyetëm se a është në rregull me procedurën.Tash është në dorën tuaj se a po doni ta lini si këshill i prindërve që unë personalisht mendoj që nuk e gëzon atë status por nëse keni të drejtë me vendos si eksperte nga ana e DKA-së,atëherë e vendosim si eksperte dhe s'ka asgjë të keqe.

Kryesuesi - do ta hedh në votim propozimin e parë ashtu si është dhe nëse nuk kalon vazhdojmë me propozimin e dytë.

Aziz Bytyqi - nëse është ligjerisht e nevojshme me u bë ndonjë ndryshim,le të bëhet.

Avni Bytyqi - së pari hedhet në votim propozimi i drejtorit pasi nuk po tërhiqet prej propozimit të vet. Nëse kalon,mirë,nëse nuk kalon kthehemi me propozimin që e dhanë anëtarët e Asamblesë.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e parë në formën që ka ardh projekt-vendimi.

13 për, 11 apstenime, Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesave;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit e mbështesim këtë vendim por kërkoj që të plotësohet ky vendim edhe me miratimin e një kërkesë që ka ardhë me 08.10.2024 nga organizata e Kryqit të Kuq e cila ka kërku një mbështetje sepse kanë pas një dëm në mjete të punës që e ka shkaktuar rryma.Të mbështetet edhe kjo organizatë por të plotësohet vendimi edhe me një shumë prej 2.000 eurosh.Kërkoj mbështetje nga kolegët.

Selman Kolgeci - në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së i përkrahim tri vendimet për familjet në Delloc,Budakovë dhe Vraniq ndërsa sa i përket propozimit,ne nuk jemi për mos me përkrah Kryqin e Kuq por ne nuk kemi asgjë përpara dhe s'po dimë çka është dëmtu te Kryqi i Kuq.

Avni Bytyqi - besoj që edhe ekzekutivi nuk është kundra për m'i ndihmu Kryqit të Kuq por Kryqi i Kuq është organizatë dhe për organizata, OJQ është Rregullorja 04/2017 për subvemncionimin e OJQ-ve me projekte të caktuara. Kur drejtoritë bëjnë thirrje publike për subvencionimin e OJQ-ve,pse Kryqi i Kuq mund të aplikoj me një projekt të caktuar dhe të realizoj dëmin që i ka ndodhur. Ndërsa ky projekt-vendim ka të bëjë vetëm me subvencionimin e personave fizik, individual.

Aziz Bytyqi - sa i takon projekteve ata po aplikojnë kur po bën thirrje Drejtoria e Kulturës por këto mjete nuk po kanë të drejtë ti përdorin për veprimtarinë e tyre por edhe sanimin e këtyre dëmeve.Nëse nuk është e mundur ligjërisht natyrisht unë nuk insisto me patjetër.

Urim Suka - ne si grup e japim gjithë mbështetjen për çdo kërkesë që na vje prej Kryqit të Kuq por në rastin konkret mendojmë që duhet me qenë kërkesë e veçantë sepse nuk mund ti përziejme këto familjet me pjesën tjetër.Kjo kërkesë le të adresohet në mënyrë të veçantë dhe le të vje këtu dhe ne jemi për me marrë si vendim për Kryqin e Kuq.Kur jemi te përkrahja për rastet emergjente,unë mendoj që ne si komunë duhet me qenë më serioz në këtë drejtim.Mendoj që është mirë mbi bazën vlerësimit të dëmit edhe vlera e kompenzimit me qenë për dikënd ndoshta më e madhe e dikënd më e vogël sepse nëse dikujt iu ka bërë dëmi 100.000€,ne nëse është mundësia me ia pagu 10.000€ dhe nëse dikujt dëmi iu ka bërë 5.000€,ne me ia pagu 500€ ose 1.000€.Nuk po flas për vendimin e sotëm por për të ardhmen dhe e përkrahim vendimin e sotëm.

Enver Shabani - i nderuari Suka,ke plotësisht të drejtë por nëse flasim për rastin konkret,që të tri shtëpitë janë të pabanueshme por ti e sqarove që nuk e kishe me rastin konkret andaj mendoj që ndarja është bërë e drejtë në këtë rast.Sa i përket rasteve tjera është mirë që në bazë të dëmeve të llogaritura nga një komision që e vlerëson edhe pas zjarrit që ndodh,është mirë me u vlerësu në bazë të dëmit që iu ka shkaktuar një familjes sepse jo të gjitha digjen në total dhe janë të pabanueshme.Fatkeqësisht tash si komunë nuk e kemi fondin emergjent.Drejtori tutje jep sqarime.

Aziz Bytyqi - tërhiqet nga propozimi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - mbledhja e Asamblesë është caktu me date 29 dhe unë mendoj që është dasht të caktohet me 25 ose 26 sepse po të ishte me 25,ne do të ishim në Shqipëri ose dikund.Pra,festat e nëntorit nuk kemi mujt me i shfrytëzu shkaku i mbledhjes së Asamblesë.Andaj vitin e ardhshëm të kesh kujdes.

Urim Suka - kam tri pyetje duke e shtu edhe këtë të temperaturave të ftohta që sot jemi detyru me mbajt këtë seancë në këto kushte kaq të ftohta. Si pushtet mendoni edhe në këtë drejtim sepse siç i pamë vendimit siç po i sillni, edhe menaxhimi i punëve le për të dëshiruar. 1. Ka një kohë të gjatë që kanë fillu punimet në rrugën “Skënderbeu” dhe malltretimet e bizneseve dhe qytetarëve janë të mëdha. Këto ditë kam marrë disa shqetësime të qytetarëve rreth këtij projekti dhe dua ti adresoj këtu. Ky projekt a parasheh që nga rrethi te autostrada deri te rrethi te varrezat, të ketë kyqje apo dalje nga njëra anë e rrugës në tjetrën? Nëse po, sa të tilla parashihen në projekt dhe sa janë duke u implementu në teren? Nëse dikush është ekspert i kësaj fushe, a mund të më tregoj që nëse ka dalje të tilla, a rrezikohet jeta e qytetarëve? Kur pritete të përmyllet si projekt? 2. Kam dy kontrata për ndërtimin e rrugëve në fshatin Greiqec. Kontrata e parë është nënshkru në vlerë prej 86.730€ dhe në këtë kontratë janë të parapara të shtrohen rrugët: “Hajriz Xhema, 8 Vëllezërit, Seferi-faza e dytë, Veterani” ndërsa në kontratën e dytë e cila është nënshkru me date 14.10.2024 dhe vlera e saj është 59.392€ ku në këtë kontratë janë parapara të shtrohen rrugët: “vazhdim i rrugës Seferi, Dy Martirët dhe Veterani”. Sipas informatave që kam marrë nga banorët, asnjëra nga këto rrugë nuk janë shtru. Cila nga këto rrugë janë shtru me këto dy kontrata? 3. Këto ditë jam njoftuar që ka pas disa dëme të konsiderueshme të serave në fshatin Njëpërbisht por edhe në disa fshatra për rreth që merren me këtë veprimtari si pasojë e disa erërave të forta. Dua të di nga ju, a është bërë vlerësimi i këtyre dëmeve dhe a keni planifikuar ti kompenzoni fermerët për dëmet e shkaktuara?

Enver Shabani - sa i përket rrugës Skënderbeu që lidh varrezat deri te rrethrrrotullimi i autostardës natyrisht si projekt është stërzgjat dhe sigurisht ka pas arsytet e veta. Sa i përket hyrje-daljeve unë saktësisht nuk e di por pasi jemi njesi e kërkesës por nuk menaxhojmë me projektin, kam një obligim moral të ju përgjigjem që me projekt ka qenë e paraparë një hyrje-dalje dhe duke marrë parasysh nga varrezat në drejtim të autostradës dhe te rrethrrrotullimi i autostradës. Me kalimin e kohës është bërë një ndryshim i projektit ku janë kriju tri dalje dhe sa paraqesin rrezik për qytetarët këtë nuk e di sepse nuk jam ekspert. Besoj që rruga “Skënderbeu” ka me përfundu brenda këtij viti. Sa i përket Greiqecit unë nuk e di saktësisht cilat rrugë janë shtru por e di që janë shtru disa rrugë kurse këtë vit me kontratën e dytë janë duke u bërë punime dhe kanë fillu dy rrugë me u shtru, rruga “Veterani” dhe rruga “Bashkimi” ka fillu me u punu dhe a përfundojnë apo jo, këtë nuk e di. Sot kemi informatë që 10 deri 15 cm ka borë në bjeshkë. Erërat e forta që kanë fry para 5-6 dite, kanë shkaktuar dëme edhe në pullaze të shtëpive dhe në shtalla të fermerëve. Ne si drejtori kemi dal në teren dhe kemi bërë verifikimin e dëmeve që janë shkaktuar nga erërat. E kemi bërë një raport brenda ditës dhe e kemi përcjell në Agjencionin e Menaxhimit të Emergjencave që ata ta bëjnë dhe një vlerësim tjetër dhe ne shpresojmë ta marrim një përgjigje pozitive sepse si Drejtori e Emergjencave nuk kemi fuqi tjetër.

Ardian Kotorri - në mëngjesin e hershëm të 22 nëntorit ka pas disa erëra të mëdhaja dhe ka dëmtu disa sera, kryesisht në fshatin Tërrnje, Njëpërbisht, Leshan, Studenqan dhe Samadraxhë. Ne nga e hëna do të dalim me stafin, do ta bëjmë vlerësimin e dëmeve të secilës kërkesë veq e veq por prej viti 2023 Ministria e Bujqësisë nuk e bën kompenzimin e dëmit, po e quaj blanko por vetëm kush e ka të siguruar. Është një pako me polisa të sigurimit që realisht një numër i vogël i fermerëve të Komunës së Suharekës që e praktikojnë. Vlerësim tjetër të dëmit nuk pranon ministria me dërgu. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - rreth përgjigjes së parë te rruga “Skënderbeu”, unë fare nuk jam ekspert për çështjet të cilat i ngrita. Unë i ngrita shqetësimet e banorëve. Disa biznese dhe disa familje aty mund të kërkojnë çasje dhe disa mund të thonë: nuk duam çasje sepse kjo ka me rreziku dhe secili ka drejtë në t’drejtën e vet por çështja është se çka është e drejta, çka është profesionalja? Kur jemi te profesionalja, projekti ka parapara një dalje aty. Gjatë rrugës ka ndërhy dikush në projekt siq ndërhyjnë gati në secilin projekt këta. Tash janë bërë tri çasje aty. A e rrezikon jetën e qytetarëve nëse aty janë tri dalje? Gjatë kyqjeve në të ardhmen na ndodhin aksidente aty, kush e merr përgjegjësinë? Unë mendoj që ne duhet me mendu për funksionimin e asaj rruge në të ardhmen dhe për sigurinë si ka me ndodh që njerëzit mos me pësua aksidente non-stop. Unë mendoj që nëse i kemi tri çasje gjatë kyqjeve prej njëres rrugë në tjetrën, mundemi me kriju mundësinë me pas shumë aksidente. Ndërsa kur jemi te Greiqeci, drejtori tha që është shtru rruga Seferi por te rruga “Seferi”, asfalti që është shtru, ka qenë një kontratë më herët sepse kjo që e përmenda këtu në fund të vitit 2023 thotë: faza e dytë e rrugës Seferi, dhe me sa e di faza e dytë nuk ka ndodh më. Kam marrë informata që po shtrohet rruga “Bashkimi” dhe është shumë mirë që po shtrohet sepse e kam pa këtë rrugë dhe e kam

ngrit më herët dhe ajo rrugë duhet të shtrohet por ajo rrugë nuk është askund në kontratë. Madje një banor më tha: nuk di që ekziston te ne rruga “Veterani” por ndoshta jam gabim dhe do ta vizitoj gjendjen atje. Te pjesa e Bujqësisë, drejtori ma kujtoi një rast, kur një fermeri në Bllacë hajnat ia kanë vjedh bagëtitë dhe unë e pata ngrit çështjen dhe drejtori pat thënë që do ti vizitojë dhe do të shoh se çka mund të bëj, por sipas asaj që di, as nuk e kanë vizitu, as nuk e kanë konpenzu dhe asgjë s’kanë bërë. Në çoftëse drejtori nuk mundet me përmbush atë që unë e ngriti, është mirë të paktën mos me kriju pritje te banorët.

Vullnet Luzhnica - përshëndet të pranishmit. Siç e dini gjatë kohës së dimrit në zonat malore ka vështirësi për shkak të reshjeve më të dendura të borës. Unë në mëngjes kam pranë telefonatë të shumta por edhe unë jetoj në atë zonë atje dhe kam pa shumë vështirësi kah erdha. A ka kontrata? Çka përfshijnë ato kontrata? Çka mirëmbajnë? Sepse edhe dimrat e kaluar, edhe këtë dimër e leje më sot nuk kanë ardhë për me hap as rrugë kryesore dhe bora është jo 15 cm por 20 deri 25 cm. Mos të harrojmë që jo shumë vite një nënë e ka humb fëmijën për shkak që rruga nuk është hap. Ka shumë pleq që kanë çdo ditë me marrë terapi në Duhël dhe Suharekë, ka shumë fëmijë të cilët duhet me i dërgu në qerdhe e nëpër shkollë e që ju pamundësohet me qenë të barabartë vetëm se jetojnë në zona malore. Nëse kontratat nuk janë të kompletuara, besoj që edhe opozita dhe pozita janë të një goje me rrit atë kontratë dhe me u mirëmbajtë.

Enver Shabani - që nga ora 08:30 jemi duke u marrë me pastrimin e borës dhe kemi dëshmi nga tereni sa është trashësia e borës, jo në Luzhnicë por në Greiqec e Papaz kurse nga Luzhnica, as unë dhe as Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk kemi marrë ndonjë informatë që ka 20 cm borë. Kemi kontratë të fuqishme, është viti i tretë që e ka kompania “Famis”. Mjete ka të mjaftueshme por natyrisht ata nuk dalin në teren kur është bora 5 cm, 10, ose 15 cm ose edhe kur ka të reshura të dendura. Është për keqardhje nëse nuk arrin fëmijët me shku në shkollë por ne nga përvoja që kemi sepse tani i bëra 7 vite, nuk kemi asnjë rast që fëmijët e kanë humb mësimin shkak i reshjeve ose i mos pastrimit të borës. Drejtori tutje jep sqarime.

Vullnet Luzhnica - kur flasim për 42 fshatra, nuk i ke krejt në zonë malore. Zonat malore duhet me qenë me prioritet. Nëse magjistratja Shtime-Suharekë-Prizren është e hapur dhe kompanitë janë duke e hap rrugën, duhet me qenë edhe ajo zonë. Unë e ngriti këtë sepse është shqetësim, sepse edhe mua dikush më kontakton me mëngjes si pikë referimi. Unë e kam për shqetësimin e njerëzve atje sepse edhe unë sot kam dal me vështirësi dhe kam ardhë me vonesë në mbledhje. Sot vetëdija e qytetarëve është shumë e madhe për këtë pjesë, por me qenë më me prioritet.

Enver Shabani - autostrada dhe rrugët regjionale sigurisht që mbahen më mirë por ne jemi duke fol për rrugët e kategorisë së dytë dhe tretë. Ne po kërkojmë një komoditet. Nëpër lagje pastrojmë rrugë kurse oborret tona nuk i kemi të pastruara. Kemi kontratën dhe po mundohemi me menagju mirë.

Vullnet Luzhnica – kompanitë, a e kanë vetëm deri në hyrje të fshatit apo edhe brenda fshatit me hap rrugë me kontratë?

Enver Shabani - me kontratë rrugët me kubëza nuk kemi nevojë me i pastru dhe nuk kanë të drejtë m’i vendos kryp sepse e dëmton betonin.

Selman Kolgeci - dua të lidhem me pyetjen e Urimit, pyetje shumë me vend por drejtori po thotë: ne jemi njesi e kërkesës, dhe nuk e din çka ka ndodh, a janë bo dy apo tri. Ajo që më intereson mua të di si njohës i fushës, a janë respektu numri i kyçjeve të lejuara në gjatësinë e caktuar që e ka rruga? Me një kyçje në kryqëzim të formës T, në atë rrugë i kemi 3 pika konfliktuoze, nëse ia shtojmë edhe 2 tjera, bëhen 9 pika konfliktuoze që është mundësi shumë e madhe me ndodh aksidente shumë të shpeshta, ndoshta jo me fatalitet por me dëme materiale. Si pasoj e kësaj unë kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që ta bëj një auditim të sigorisë rrugore për atë segment dhe në seancën tjetër me na sjell auditimin e sigorisë. Shumë mirë që e keni lënë ishullin qëndror 2 metra por në raste kur kemi teren të mjaftueshëm është jashtëzakonisht i mirë. Në rastin konkret ju e keni lënë ishullin qëndror 2 m dhe në anën tjetër i keni bërë tri kyçe. Unë e di që kyçe secili ka me kërku por nëse bëjmë diçka, ta bëjmë mirë.

Enver Shabani - nuk e di a mund ta marrë përsipër këtë auditim që po e kërkon sepse nuk e di a është në kompetencën tonë sepse ndryshimet i kanë bërë ekspertët.

Mimoza Bajraktari - pyetjen që e bëri Vullneti, unë e mora informatën direkt nga vendi por një herë duhet të pastrohet rruga e Javorit gjë që e ka një kompani nga Ferizajë e cila është e kontraktuar e mandej në Luzhnicë por për fat të mirë kamioni qenka te Javori.

Takimi përfundoi: 11:40

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj